

L I G J
Nr.8115, datë 29.3.1996

**PËR NJË PËRJASHTIM NGA RREGULLAT E PARASHIKUARA NË TRASHËGIMINË
LIGJORE SIPAS KODIT CIVIL TË MIRATUAR ME LIGJIN NR.6340, DATË 26.6.1981**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 23 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e një grupi deputetësh

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Në përjashtim nga rregullat e parashikuara në nenet 104, 105, 106 e 107 të Kodit Civil të miratuar me ligjin nr.6340, datë 26.6.1981, për pasuritë që kthehen nga zbatimi i ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, kur bashkëshorti pasjetues nuk konkurron me trashëgimtarë të tjerë të radhës së parë, në trashëgim thirren edhe vëllezërit e motrat e trashëgimlënësit ose trashëgimtarët e tjerë të tyre që thirren me përfaqësim. Në këtë rast, bashkëshorti pasjetues merr 1/2 e trashëgimit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij qysh nga data 16.5.1993 që është ajo e hyrjes në fuqi të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993.

Shpallur me dekretin nr.1473, datë 18.4.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha